



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Nr. _____ Prot

Korçë, më 08.11.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Date 08.11.2023

Drejtuar: *Shoqërisë "Kurora" sh.p.k, adresa: Elbasan, Gramsh, Lagja Sporti, pallati i ri, pranë kishës ortodokse.*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës **REF-80547-09-19-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **"Pyllëzime Krushovë"**

Afati:

Procesi i mbjelljes bëhet gjatë periudhës së pushimit të vegjetacionit konkretisht periudha Tetor- Mars. Në vendet malore, për shkak të kushteve atmosferike kjo periudhë mund të zgjatet deri në 15 Prill. Sherbimet e tjera që do të kryhen mbas mbjelljes do të shtrihen brenda tre viteve nga mbjellja e fidaneve

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr 80 Date 25.09.2023, Nr 90 Datë 06.11.2023.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria "Kurora" shpk, NIPT J76314803S me vleren:

10.733.011,21 (dhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e njëmbëdhjetë, presje njëzet e një) lekë pa tvsh.

2. Bashkimi i shoqërive "Gjelbërimi" shpk, NIPT K33810023R dhe "Gjelbërimi 2000" shpk, NIPT

L21513012D me vleren:

12.363.281,70 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e një, presje shtatëdhjetë)

3. Shoqëria “ Nika”shpk, NIPT J76705047U, me vleren:

12.486.589,50 (dymbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë, presje pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

4. Bashkimi i shoqërive “ Lurimi”shpk, NIPT J68403912U dhe “ Dema Construction 2014 ”shpk, NIPT L41714507K me vleren:

12.695.714,00 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e katërdhjetë) lekë pa tvsh

5. Bashkimi i shoqërive “ Xhepi ” shpk, NIPT K84509202A dhe “ Niem ” shpk, NIPT K36609610Q

13.366.506,33 (trembëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtë, presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

❖ Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i shoqërive “ Xhepi ” shpk, NIPT K84509202A dhe “ Niem ” shpk, NIPT K36609610Q për arsye se:

1. Bazuar në Aktmarrëveshjen e bashkëpunimit Shoqëria “Niem “ sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë 49% të punimeve të parashikuara . Nga shqyrtimi i elementëve konkretë që shoqëria Niem sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër punime nga të gjitha zërat e preventivit ,perveç zerit ”Blerje plehu kimik”. Për sa më sipër kjo shoqëri bazuar në nenin 88 të VKM 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” duhet të përmbushë kërkesat për kualifikim referuar përqindjes dhe punëve/shërbimeve konkrete që ka marrë përsipër të kryejë në akmmarrëveshje.

Për sa më sipër shoqëria Niem :

a-Nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit

b-Nuk ploteson kriterin e percaktuar në dokumentat e tenderit,shtojca 8 pika 2.2.1 , lidhur me shërbimet e mëparshme të ngjashme.

Kontratat e paraqitura nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

c- Nuk ploteson kriterin e percaktuar në dokumentat e tenderit,shtojca 8 pika 2.2.2,pika a,b,c.

Duke qënë se shoqëria shoqëria Niem sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë furnizimin pjesërisht me fidanë dhe mbjelljen e fidanëve rrjedhimisht duhet të kishte paraqitur dhe licencat e parashikuara në pikat me sipër.

2-Sigurimi i ofertës nuk është i rregullt për arsye se :

a-nuk është specifikuar bashkimi i shoqërive cka bie në kundërshtim me percaktimin e bere në 88 pika 2 të VKM 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se “*Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*”

b. Objekti i tenderit është shenuar gabim

3- Shoqëria Xhepi sh.p.k nuk ploteson kriterin e percaktuar në dokumentat e tenderit,shtojca 8 pika 2.2.1 , lidhur me shërbimet e mëparshme të ngjashme.

Shoqëria Xhepi ka paraqitur dy kontrata të lidhur me një subjekt privat por nuk ka paraqitur faturat lidhur me keto kontrata.

Gjithashtu ka paraqitur edhe një faturë me vlerë 825000 lekë,pa tvsh, e cila është me e vogël se vlera e kërkuar .

4-Ofertuesi nuk ka paraqitur preventivat ne perputhje me preventivat e publikuar nga autoriteti kontraktor . Konkretisht ofertuesi nuk ka dorezuar sipas formatit te publikuar preventivin “Preventiv me zerat total përfshirë zëvendësimet dhe tre vite shërbime”

Gjithashtu ofertuesi ka ndryshuar volumet e punimeve në zerin “Hapje gropash 40x40x40 cm në tokë të fortë gurishtore” nga autoriteti kontraktor eshte percaktuar 30.30 dite pune , nga ofertuesi eshte shenuar 30.31

Në zerat“Uitje fidanash në pyllëzime me 30 l. ujë, kur uji është mbi 100 m. largësi (2 herë)” volumi i punes i shenuar nga autoriteti kontraktor eshte 3334 dhe ditë pune 33.34 ndersa nga ofertuesi eshte shenuar perkatesisht 3335 dhe 33.35

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “**Kurora**”shpk, me adresë: Elbasan, Gramsh, Lagjja Sporti, pallati i ri, pranë kishës ortodokse, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10.733.011,21 (dhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e njëmbëdhjetë, presje njëzet e një) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Korçë, Drejtoria e Prokurimeve, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi por jo me vonë se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vijohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**